

KONTRATË SHITJE-BLERJE PJESËSH KAPITALI

Sot më datë 08/02/2022, lidhet kjo Kontratë Shitje-Blerje Pjesësh Kapitali (këtej e tutje referuar “Kontrata”),

ndërmjet

- **Zj. Orjana Kalaja**, qytetare shqiptar, lindur më 26.01.1980, në Tiranë, Shqipëri me karte identiteti nr. 037462757, me banim në Rr. Sitki Cico, Pall.2K, hyrja 3, kati 3, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje referuar si “Shitësi”);

dhe

- **Western Balkan Alliance Sh.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me NUIS: M02304017Q me seli në Rr. Ismail Qemali, Pall.29, kati 3, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga administratorja **Zj. Silvana Kuqo**, qytetare shqiptar, lindur më 03.02.1967, në Tiranë, Shqipëri me karte identiteti nr. 034345169, me banim në Rr. Perlat Rexhepi, Pall.11, Ap.71, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje referuar si “Blerësi”);dhe

Shitësit dhe Blerësi individualisht referuar si “Pala” dhe bashkërisht referuar si “Palët”.

KUSHTET PARAPRAKE

- a) Shitësi zotëron 100% (njëqint përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë **Nexia AL Sh.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me NUIS K91721010Q, me seli në Rr. Margarita Tutulani, Pall.Viridario 1, Kati 2-te, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje “Shoqëria”);
- b) Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, dhe Blerësi dëshiron të blejë këtë pjesë kapitali mbi bazën e kushteve dhe termave të mëposhtme;

MEQË EKZISTOJNË KUSHTET PARAPRAKE,
PALËT BIEN DAKORT PËRSA MË POSHTË:

Neni 1 - Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme ashtu si edhe shtojcat (nëse ka) janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 2 – Objekti i Kontratës & Çmimi

2.1 Shitësi i shtet Blerësit, të lirë nga çdo barrë apo detyrim apo nga ndonjë e drejtë tjetër dhënë për ndonjë palë të tretë, një pjesë kapitali të barabartë me 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (këtej e tutje referuar si “Pjesa e Kapitalit”), në këmbim të çmimit total prej LEK 1.470.000 (njëmiljon e katërqind e shtatëdhjetë lekë), çmim të cilin Palët pranojnë se është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Palët deklarojnë dhe garantojnë se çmimi total i blerjes së kuotave sipas kësaj marreveshjeje në lidhje me Pjesën e Kapitalit, do të paguhet nëpërmjet transferimit në llogarinë bankare të shitësit.

2.2 Palët bien dakord se me transferimin e Pjesës së Kapitalit sipas nenit 2.1 të kësaj Kontrate, Blerësi do të ketë në pronësi 49% (dyzet e nëntë përqind) dhe Shitësit do të ngelen 51% (pesëdhjetë e një përqind) të Kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 3 – Transferimi i Pjesës së Kapitalit

Palët bien dakord se transferimi i Pjesës së Kapitalit do të ketë efekt ligjor nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të Shitësve

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shitësit deklarojnë dhe garantojnë se:

- (a) pjesët e kapitalit të transferuara sipas kësaj Kontrate janë të lira nga çdo barrë apo detyrim apo nga ndonjë e drejtë tjetër dhënë për ndonjë palë të tretë, dhe se Shitësit kanë titull, të drejtë dhe kompetencë të plotë për të shitur dhe transferuar pjesët e kapitalit në përputhje me këtë Kontratë;
- (b) i kalojnë Blerësit titull ligjor të plotë në lidhje me pjesën e kapitalit përkatëse, transferuar në përputhje me këtë Kontratë.
- (c) Shitësi do të paguajë çdo taksë të aplikuar në lidhje me shitjen e Pjesës së Kapitalit sipas kësaj Kontrate;

Neni 5 - Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësi nëpërmjet këtij akti deklaron dhe garanton se:

- (a) ka autoritet dhe tagra të plota për të marrë pjesë në këtë Kontratë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të;
- (b) Blerësi nuk ndodhet në procedure falimentimi ose likuidimi dhe nuk ka ndonjë rrezik që të nënshtrohet këtyre procedurave;
- (c) Blerësi, në mënyrë të pavarur, ka verifikuar aktivitetin, librat e Shoqërisë, vendimet e asamblese se ortakeve se bashku me efektet financiare të tyre si edhe gjendjen financiare të shoqërisë deri në datën e kësaj kontrate;

- (c) Blerësi, në mënyrë të pavarur, ka verifikuar aktivitetin, librat e Shoqërisë, vendimet e asamblese se ortakeve se bashku me efektet financiare të tyre si edhe gjendjen financiare të shoqërisë deri në datën e kësaj kontrate;
- (d) do të paguajë shpenzimet që lidhen me këtë Kontratë, përfshirë shpenzimet bankare (nëse ka).

Neni 6 – Trashëgimtarët apo përfituesit nga ndonjë kalim apo cedim

Kjo Kontratë do të jetë detyruese apo në përfitim të Palëve dhe trashëgimtarëve apo përfituesve të tyre për shkak të ndonjë kalimi apo cedimi.

Neni 7 – Ligji i zbatueshëm & Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimit e Palëve do të rregullohen, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 7.2 Në rast mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, përfundimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, Palët do të takohen dhe përpiqen në mirëbesim të zgjidhin sa më shpejt që të jetë e mundur mosmarrëveshjen në fjalë. Nëse kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve ndërmjet Palëve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga kërkesa e parë për takim, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 7.3 Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në shqip.


Neni 8 – Të Ndryshme

Palët bien dakord dhe konfirmojnë se, në përputhje me ligjin shqiptar, të gjitha tarifat noteriale dhe administrative në lidhje me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të përballohen nga Blerësi.

* * * * *


PËR SA MË SIPËR, Palët deklarojnë se kjo Kontratë është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruajnë atë në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

SHITËSIT


Znj. Orjana Kafaja

BLERËSI

Western Balkan Alliance shpk.
Perfaqesuar nga Administratori


Znj. Silvana Kuqo


Western Balkan Alliance sh.p.k.
NIPT: M02304017Q